




BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ÇERDHEVE DHE KOPSHTEVE

Programi i Muajit Qershor

Mosha 6-18 Muaj



Muaji Qershor



Përshëndetje vogëlushë!

- * Unë jam Qershori, muaji i parë i stinës së verës.
- * Unë vij bashkë me **1 Qershorin**, ditën dhe festën tuaj.
- * Emri Qershor në shqip, vjen nga qershitë, të cilat behën në këtë kohë.
- * Frutat, lëngjet, akulloret me shijet e ndryshme janë shumë të mira.
- * Dielli shkëlqen dhe na ngroh, qielli është plot me yje, ndërsa mbremja vjen ngadalë.
 - * Natyra është e bukur sepse lulet dhe pemët kanë çelur kudo.

Muaji Qershor - Tema e Muajit - Karakteristikat e Stinës së Verës

Grupi: 6-18 muaj

- * **Java I:** Festa e 1 Qershorit. Elementë të stinës së verës.
- * **Java II:** Frutat dhe perimet e stinës
- * **Java III:** Veshjet e fëmijëve
- * **Java IV:** Format e argëtimit

Tema mujore: Njohja me Karakteristikat e Stinës së Verës & Festa e 1 Qershorit

Temat Javore	Qëllimi	Koha e realizimit
Festa e 1 Qershorit dhe karakteristikat e stinës së verës	Aktiviteti festiv. Njohja me disa elementë të stinës së verës.	Java I
Frutat dhe perimet e stinës së verës	Njohja me frutat dhe perimet e stinës	Java II
Ngjyrat dhe numrat tek veshjet e fëmijëve në verë	Njohja me veshjet karakteristike të fëmijëve për verën	Java III
Sa gëzim erdhi vera!!!	Format e argëtimit	Java IV



Shënim:



- * Stafi edukator duhet të realizojë programin në mënyrë sa më të thjeshtë. Kryesisht në formën e lojës duke u nisur nga mosha e vogël si dhe duke marrë në konsideratë kushte dhe situata të caktuara brenda grupit.

Tema mujore: Stina e Verës


Tema e javës I: Festa e 1 Qershorit. Elementë të Stinës së Verës.



Java I	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
E Hënë	1 Qershorit Festa Jonë!	Aktivitet festiv: Këngë dhe muzikë. Fëmijët kërcejnë së bashku.	Manuali i Vjershave
E Martë	<p style="text-align: center;">Dielli</p> 	<p>Aktivitet: Edukatorja përmes ilustrimeve si në figurë u flet fëmijëve për diellin. Krijimi i “Diellit” si maskë prej kartoni (përgatitur më parë). Fshihet dhe shfaqet fytyra e fëmijës pas diellit. Preken sytë, hunda me gisht (6-12 muaj).</p> <p>Vjersha: “Dielli”</p> <p>Këngë lëvizore</p>	Manuali i Vjershave Kartonë, mjete didaktike
E Mërkurë	<p style="text-align: center;">Fytyra ime e qeshur si Diell</p> 	<p>Aktivitet: Maska e diellit (një ditë më parë) vendoset para fëmijës. Tregohet/preket me gisht, goja, hunda. Identifikimi i shqisave në fytyrën e fëmijës(12-18 muaj).</p> <p>Loja energjike: Lojëra ritmike me muzikë të drejtuara nga edukatorja.</p> <p>Vjersha: “Dielli”</p>	Manuali i Vjershave Kartonë, mjete didaktike

E Enjte	<p style="text-align: center;">Ngjyrat dhe lulet</p> 	<p>Aktivitet: Përmes ilustrimeve si në figurë edukatorja iu tregon fëmijëve për lulet, ngjyrat konkretisht blu dhe e kuqe.</p> <p>Mund të përdoren bluzat që fëmijët kanë veshur me dizeno lulesh të cilat tregohen me gisht, preken nga fëmijët.</p> <p>Loja: “Bërja e flluskave”</p> <p>Muzikë dhe këngë</p>	Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave
E Premte	<p style="text-align: center;">Zogu i vogël</p> 	<p>Aktivitet: Përmes formave, vizatimeve, ilustrimeve si në figurë edukatorja iu tregon fëmijëve për zogjtë.</p> <p>Aktivitet i improvizuar: Edukatorja nxit fëmijët në imitim të zogjve “Ciu, ciu...”, rrahja e krahëve.</p> <p>Prekja e zogjve lodër që lëshojnë tinguj.</p> <p>Vjersha: “Zogu im”</p>	Manuali i Vjershave Zogj lodër

Tema mujore: Stina e Verës
Tema e javës II: Frutat dhe Perimet e Stinës









Java II

Rubrika

Aktivitetet

Mjetet e Punës



<p>E Hënë</p>	<p>Qershia</p> 	<p>Aktivitet: Përmes ilustrimeve si në figurë, lodrave plastike apo frutit të qershisë edukatorja iu tregon fëmijëve për qershinë dhe ngjyrën e saj të kuqe.</p> <p>Vjersha: “Qershia”</p> <p>Muzikë dhe këngë për fëmijë</p>	<p>Manuali i Vjershave Lodra Plastike</p>
<p>E Martë</p>	<p>Luleshtrydhja</p> 	<p>Aktivitet: Përmes ilustrimeve si në figurë edukatorja iu tregon fëmijëve për luleshtrydhen, ngjyrën e saj të kuqe.</p> <p>Loja: “Shporta ime”. Me ndihmën e edukatores fëmijët vendosin në shportë frutat me ngjyrë të kuqe.</p> <p>Muzikë: Lojëra ritmike me muzikë</p>	<p>Manuali i Vjershave Lodra si fruta</p> 
<p>E Mërkurë</p>	<p>Banania</p> 	<p>Aktivitet: Përmes ilustrimeve si në figurë, edukatorja iu tregon fëmijëve frutin e bananes.</p> <p>Këngë lëvizore: “Sa i dua frutat”</p> <p>Muzikë dhe këngë</p>	<p>Manuali i Vjershave Banane</p>

<p>E Enjte</p>	<p style="text-align: center;">Vagonat me fruta</p> 	<p>Aktivitet: Përmes formave/figurave edukatorja tregon/specifikon frutat (6-12 muaj) të cilat mund të mbahen në dorë apo preken nga fëmijët.</p> <p>Aktivitet: “Kënga Treni” shoqërohet nga edukatorja duke bërë emërtimin dhe zëvendësimin e frutave (mbi 15 muaj).</p> <p>Këngë lëvizore: “Sa i dua frutat”</p>	<p>Manuali i Vjershave Mjete didaktike</p>
<p>E Premte</p>	<p style="text-align: center;">Karota</p> 	<p>Aktivitet: Përmes ilustrimeve, lodrave, edukatorja iu tregon fëmijëve për karotën. Mund të përdoren karotat lodër, por dhe si frut.</p> <p>Vjersha: “Karota”</p> <p>Loja: “Kërcim në vend”</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave</p>

Tema mujore: Stina e verës

Tema e javës III: Veshjet e fëmijëve dhe ngjyrat në stinën e verës






Java III	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
E Hënë	Veshjet e mia 	Aktivitet: Edukatorja iu demonstroi fëmijëve si vishet dhe zhvishet një kukull. Loja: “Me pasqyrë” Fëmijët shohin veshjen e tyre në pasqyrë. Emërtimi nga edukatorja si fillim dhe imitim nga fëmija. (12-18 muaj) Vjersha: “Kam një kukull”	Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave
E Martë	Veshjet e kukullës 	Aktivitet: “Kukulla që vishet”. I vishet kukullës një emër, vishen dhe zhvishen rrobat e kukullës së bashku me fëmijët. (12-18 muaj) Vjersha: “Kam një kukull” Këngë lëvizore.	Manuali i Vjershave Kukulla, veshje

<p>E Mërkurë</p>	<p>Çorapet e mia</p> 	<p>Aktivitet: Edukatorja vesh dhe zhvesh çorapet tek fëmijët, veprim që përsëritet disa herë.</p> <p>Loja: “Me pasqyrë”. Fëmijët shohin çorapet dhe këmbët në pasqyrë (emërtimi i ngjyrave nga edukatorja).</p> <p>Loja energjike: “Roza-rozina”(mbi 12 muaj)</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave</p>
<p>E Enjte</p>	<p>Kapelja ime</p> 	<p>Lojë: “Me kapelë” Edukatorja ndihmon fëmijët të vendosin kapelen në kokë emërtojnë së bashku ngjyrat e tyre. Bashkëpunojnë me prindërit që të sjellin nga një kapelë për fëmijët.</p> <p>Loja energjike: “Kërcejmë në vend”</p> <p>Vjersha: “Kam një kukull”</p>	<p>Manuali i Lojrave Kapele për fëmijë</p>
<p>E Premte</p>	<p>Ngjyrat në veshje</p> 	<p>Loja: “Emërtimi i ngjyrave”</p> <p>Të vendosur në formë rrethi edukatorja emërton dhe tregon me gisht ngjyrat e veshjeve të fëmijëve.</p> <p>Këngë lëvizore</p>	<p>Manuali i Vjershave</p>

Tema mujore: Stina e Verës

Tema e javës IV: Sa gëzim që erdhi Vera...! Format e argëtimit.



Java IV	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
E Hënë	<p style="text-align: center;">Topa me ngjyra</p> 	<p>Loja: “Topat me ngjyra”</p> <p>Fëmijëve i kërkohet të prekin topat dhe t’i kapin ato. Me ndihmën e edukatores fëmijët numërojnë dhe emërtojnë ngjyrën e topit. (12-18 muaj)</p> <p>Vjersha: “Topi im”</p> <p>Këngë lëvizore</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Topa me ngjyra(blu dhe i kuq)/materiale të ndryshme</p>
E Martë	<p style="text-align: center;">Topi im</p> 	<p>Vjersha: “Topi im”</p> <p>Lojëra energjike: “Kukafshehti”</p> <p>Edukatorja fsheh topin nën batanije duke pyetur fëmijët: “Ku është topi?”. Kjo për të nxitur vetdijësimin e vazhdimësisë së objektit.</p>	<p>Manuali i Vjershave Topa të ndryshëm</p>
E Mërkurë	<p style="text-align: center;">Lodrat e plazhit</p> 	<p>Aktivitet: Përmes ilustrimeve si në figurë, edukatorja iu tregon fëmijëve për lodrat e plazhit.</p> <p>Loja: “Numërojmë dhe luajmë me lodrat e plazhit”. Edukatorja numëron deri në 3 (tre) lodra.</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Lodra plazhi</p>

		Këngë lëvizore : “Rosat lahen në liqen”	
E Enjte	<p>Pipëzat</p> 	<p>Loja: “Pipëzat” Edukatorja përmes pipëzave mund të fryjë ajër fëmijëve (6-12muaj) ose bërja e flluskave nga fëmijët (12-18 muaj).</p> <p>Loja energjike: “Roza-rozina” (mbi 12 muaj)</p> <p>Vjersha: “Rosat lahen në liqen”</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Lodra e flluskave Pipëza</p>
E Premte	<p>Improvizimi i detit</p> 	<p>Loja ndijore: Fëmijët me ndihmën e edukatores prekin me dorë qeset e improvizuara si det. Edukatorët nxisin të treguarit me gisht dhe njohjen e elementëve të detit.</p> <p>Këngë lëvizore</p>	<p>Manuali i Vjershave</p>